

I. Shpalljen e funksioneve të lira për konkurrim në strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore.

II. Kandidatët që aplikojnë për pozicionet civile duhet të plotësojnë kriteret bazë të mëposhtme:

- **Kritere e domosdoshme për përzgjedhjen e aplikantit**

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të mos jetë i dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale;
- c) të mos ketë marrë masën disiplinore përjashtim nga Agjencia, nga strukturat e tjera ligj zbatuese dhe të sigurisë kombëtare, ose të jetë larguar nga shërbimi civil dhe administrata publike;
- ç) të jetë i aftë nga ana shëndetësore, e vërtetuar me vendim të komisionit mjeko-ligjor;
- d) të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve në shkencat juridike, ekonomike, informatike ose institucionet arsimore të sigurisë;
- dh) të plotësojë kushtet e kriteret për t'u pajisur me Certifikate të Sigurimit të Personelit;
- e) të plotësojë kriterin e eksperiencës në punë sipas pozicionit për të cilin është shpallur vendi i lirë, si vijon:

i. për pozicione pune të nivelit ekzekutiv, aplikantët duhet të kenë eksperiencë pune jo më pak së 2 vjet në struktura të cilat gëzojnë atributet e Policisë Gjyqësore apo struktura të administratës publike;

ii. për pozicione pune të nivelit të ulët drejtues, aplikantët duhet të kenë eksperiencë pune jo më pak së 5 vjet në struktura të cilat gëzojnë atributet e Policisë Gjyqësore apo struktura të administratës publike;

iii. për pozicione pune të nivelit të mesëm drejtues, aplikantët duhet të kenë eksperiencë pune jo më pak së 10 vjet në struktura të cilat gëzojnë atributet e Policisë Gjyqësore apo struktura të administratës publike, si dhe 3 vitet e fundit në pozicione drejtuese në nivel sektori apo drejtorie.

- **Kritere të veçanta:**

- a. Të ketë aftësi të mira analitike në njohjen e sistemeve kompjuterike;
- b. Të ketë aftësi të mira vlerësuese dhe gjyqësore;
- c. Të ketë aftësi shkrimi dhe arsyetimi ligjor;
- d. Të ketë aftësi organizative të punës në grup;

- **Procedurat e aplikimit**

- a. Aplikanti plotëson formularin standard të aplikimit të hedhur në faqen zyrtare të AMP-së
- b. Bashkëngjit dokumentacionin për aplikim dhe i dorëzon në zyrat postare të qarkut, rrethit, qytetit ose i dorëzon dorazi në zyrën e informacionit të Agjencisë në godinën e saj, në adresën: Rruga Asim Vokshi, nr.19/1, Tiranë

- **Afati për fillimin e përfundimit të i aplikimit**

- a. Fillon me datë 14.08.2025 deri me datë 21.08.2025. Dokumentacioni duhet të jetë në AMP, brenda këtij afati. Pas kësaj date nuk pranohen aplikime

- **Dokumentacioni që kërkohet për aplikim**

Për aplikim për punonjës të Agjencisë, aplikantët duhet të paraqesin pranë strukturës përgjegjëse te burimeve njerëzore, dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) formularin e plotësuar të aplikimit;
- b) fotokopje të kartës së identitetit;
- c) kopje origjinale ose fotokopje të noterizuar të cikleve të studimit, e shoqëruar me listë notash;
- ç) certifikate të gjendjes gjyqësore;
- d) 2 foto me përmasa 4 x 6 cm;
- dh) vërtetim nga përmbartimi gjyqësor, prokuroria, dhe gjykata që nuk janë në ndjekje penale;
- e) raport mjeko ligjor mbi gjendjen shëndetësore;
- ë) dokument për vërtetimin e përvojës në punë;
- f) vlerësimin e fundit të punës, kur aplikantët vijnë nga administrata shtetërore.

- **Fazat e pranimit**

- a) testimit me shkrim;
- b) intervistës me gojë;
- c) kontrollit shëndetësor;
- ç) verifikimit përfundimtar të aplikantit.

- **Vlerësimi i kandidatëve në procesin e testimit**

- a. Aplikanti i nënshtrohet procedurave të kontrollit të dokumentacionit të aplikimit nëse janë në përputhje me listën e dokumentave të shpallura për aplikim.
- b. Aplikantët të cilët plotësojnë kriteret bazuar në dokumentacionin të kërkuar kualifikohet në fazën e testimit me shkrim.
- c. Aplikantët të cilët në testimin me shkrim arrijnë 70 pikë e më shumë kalojnë në intervistën me gojë.
- d. Rezultati i testimit me shkrim, përbën 60% të rezultatit të përgjithshëm të konkurrimit.
- e. Intervista me gojë përbën 30% në rezultatit të përgjithshëm të konkurrimit.
- f. Vlerësimi i dosjes së aplikantit (niveli shkollimit, trajnimeve dhe përvojës në punë, përbën 10% në rezultatit të përgjithshëm të konkurrimit)

III. Korpusi ligjor ku duhet të referohet aplikanti.

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar
- Kodi Penal, në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar
- Kodi i Procedurës Penale, në Republikën e Shqipërisë
- Kodi Civil, në Republikën e Shqipërisë
- Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë
- Ligji 128/2021 “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”.
- VKM Nr. 532, datë 29.07.2022 Për miratimin e Rregullores “Për funksionimin e së Agjencisë e Mbikëqyrjes Policore”

IV. Funksionet e shpallura për konkurrim janë:

- Këshilltar në Kabinetin e Drejtorit të Përgjithshëm, 1 (një) pozicion
- Shef sektori, në Sektorin e Pritjes së Qytetarëve, në Drejtorinë e Inspektimit dhe Ankesat, 1 (një) pozicion
- Specialist në Sektorin e Pritjes së Qytetarëve, në Drejtorinë e Inspektimit dhe Ankesat, 1 (një) pozicion

- Specialist në Sektorin e hetimit/Polici së Gjyqësore, në Drejtorinë e Hetimit 1 (një) pozicion
- Specialist në sektorin e Hetimit/Ankesave, Sektori Vlorë, në Drejtorinë Rajonale Vlorë – Gjirokastrë, 1 (një) pozicion
- Specialist në sektorin e Hetimit/Ankesave, Sektori Gjirokastrë, në Drejtorinë Rajonale Vlorë – Gjirokastrë, 1 (një) pozicion
- Specialist në sektorin e Hetimit/Ankesave në Drejtorinë Rajonale Durrës – Kavajë, 1 (një) pozicion



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE**

Lidhja nr.1

FORMULARI I APLIKIMIT PËR PRANIM NË AMP

Institucioni

AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE

Pozicioni per te cilin aplikon

Qarku/Rrethi

TE DHENA PERSONALE

EMER: _____ _____	MBIEMRI: _____
DATËLINDJA: _____	ADRESA: _____
Email: _____	TELEFON/CELULAR: _____

EDUKIMI

INSTITUCIONI: _____ (arsimor)	FAKULTETETI: _____
INSTITUCIONI: _____ (arsimor)	FAKULTETETI: _____
INSTITUCIONI: _____ (arsimor)	FAKULTETETI: _____
TITULLI: _____	TIPI I STUDIMEVE: _____

TITULLI: _____	TIPI I STUDIMEVE: _____
TITULLI: _____	TIPI I STUDIMEVE: _____
DATA E FILLIMIT: _____._____._____	DATA E MBARIMIT: _____._____._____
DATA E FILLIMIT: _____._____._____	DATA E MBARIMIT: _____._____._____
DATA E FILLIMIT: _____._____._____	DATA E MBARIMIT: _____._____._____
VENDI: _____	
VENDI: _____	
VENDI: _____	

PERVOJA PROFESIONALE

INSTITUCIONI/FIRMA _____	POZICIONI I PUNES _____
INSTITUCIONI/FIRMA _____	POZICIONI I PUNES: _____
INSTITUCIONI/FIRMA _____	POZICIONI I PUNES: _____
INSTITUCIONI/FIRMA _____	POZICIONI I PUNES _____
	POZICIONI I PUNES: _____
PERIUDHA E PUNESIMIT: _____	Telefon: _____
PERIUDHA E PUNESIMIT _____	Telefon: _____
PERIUDHA E PUNESIMIT: _____	Telefon: _____
PERIUDHA E PUNESIMIT: _____	Telefon: _____
PERIUDHA E PUNESIMIT: _____	Telefon: _____

Shto pervoje

Gjuhe te huaja

Gjuha	Niveli
Anglisht	

Frengjisht	
Gjermanisht	

Shto gjuhen

1. Plotësoni çdo kuti në këtë aplikim në mënyrë të plotë. Një aplikim i paplotë mund t'ju skualifikojë nga procesi i përzgjedhjes.
2. Përgjigjuni çdo pyetje duke thënë vetëm të vërtetën. Përgjigjet e rreme do t'ju skualifikojnë automatikisht.
3. Plotësoni informacionin e kërkuar me stilolapës dhe germa kapitale. Në rast se shkrimi nuk është i kuptueshëm, ju mund të skualifikoheni.
4. Nëse një pyetje nuk aplikohet në rastin tuaj, ju lutemi plotësoni kutinë përkatëse duke shkruar "N/A" (nuk aplikohet).

Tirane, _____. 2025

(Emer, Mbiemri, Firma e Aplikantit)